



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR**

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, ëeb: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail:
info@bashkiashkoder.gov.al, Tel: +35522400150

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

**“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESEM 2023-2025 TË
BASHKISË SHKODËR”.**

Konsultim publik : *Banorët e Nj. Administrative Bërdicë.*

Data : 11.10.2022

Ora : 13.00

Vendi: *Nj. Administrative Bërdicë.*

Numri i pjesëmarrësve : *Numri i pjesëmarrësve 29, nga të cilat 4 gra dhe vajza.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Për draft projekt planin buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Bashkisë Shkodër*

Pjesëmarrës : *Drejtues dhe specialiste të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).*

Takimi bashkë-drejtohet nga Zv/Kryetari i bashkisë dhe Kryetarja e Këshillit Bashkiak të cilët bënë një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morën fjalën, diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Hapja konsultimit nga Zv/Kryetari i Bashkisë, fjala përshëndetëse dhe prezantimi i pjesëmarrësve pjesë e stafit të Bashkisë Shkodër në takim.

Arsimi baze parashkollor i Mesëm dhe i Përgjithshëm.

Drejtuese e shkollës ‘Sait Tagami’, Besë Pellumbi – shkolla ka 254 nxënës të arsimit bazë dhe 60 nxënës të kopshtit pra 320 nxënës në total, pothuajse është shkollë e mirëmbajtur dhe ka investime por më shumë në mirëmbajtje kemi ndërhyrje nga komuniteti, përveç levdave kemi edhe problematika

1. Dritaret e shkollës janë riparuar por sa herë që ka rreshje kemi ujë në klasa
2. Dyert kanë nevoja për riparime në sistemimin e bravave sepse nuk funksionojnë
3. Tek pjesët ku ka dëmtime pajisjesh, kërkojmë që të zvendësohen me pajisje të reja sepse i kemi mbyllur për momentin
4. Ngrohja është me dru dhe oxhaqet nuk janë pastruar asnjë herë që 14 vite dhe kemi shumë problem sepse nuk arrijmë t’i ndezim.
5. Ka tre vite që sjellim kërkesën në bashki për ndërhyrje tek kabineti i informatikës ku është dëmtuar rrjeti i shpërndarjes – herë pas here na është premtuar po që tre vite nuk kemi asgjë.
6. Në oborr ditët që janë me shi kemi prezencë të ujit sepse afër kemi një kanal që nuk pastrohet dhe për një ditë shi i gjithë oborri mbetet i mbytur për një javë .
7. Lagshtirë në mjediset e shkollës që megjithë mbështetjen e komunitetit e kemi të vështirë ta përballojmë.
8. Shkolla është në kryqëzim dhe nuk ka sinjalistike të posaçme për menaxhimin e fluksit të makinave dhe personave që shoqërojnë fëmijët në shkollë. Sinjalistika rrugore është e domosdoshme dhe prioritet maksimal sepse behët fjalë për sigurinë e fëmijëve.
9. Nga data 3 e këtij muaji sanitarja ka dalë në pension dhe kemi vetëm një sanitare – me 4 kate shkollë, tualete, hapsira etj. Do preferonim të merrej edhe mendimi ynë. Shkolla është qendër komunitare dhe ka detyra edhe pasdite deri në 4 e gjysëm pra nevoja është shumë e madhe dhe duhet sa më shpejt të punësohet sanitarja duke marrë parasysht numrin e lartë të nxënësve.

Shkolla Frederik Gjoni –“ Mark Mnela” – Shkollë e mesme e bashkuar.

Në shkollë janë kryer investime por më sa shohim kemi akoma shumë nevoja sepse investimet që janë kryer lënë shumë për të dëshiruar.

Problemet janë të ndryshme:

1. Lagëshirat që streha krijon ka shumë rrjedhje është bërë një inspektim dhe disa riparime
2. Uji i pijshëm në shkollë është i papijshëm dhe jashtë cdo standardi. Janë bërë edhe raportime por akoma nuk është zgjidhur asgjë. Kemi edhe shpim por nuk mund të pihet
3. Dyert janë të nevojshme të rikualifikohen.
4. Dritaret, xhamat janë po ashtu të nevojshme të investohen.
5. Bravat e dyerve duhen riparuar dhe të sillet dikush që i punon.

6. Shkolla nuk ka palester dhe ambjent të dedikuar për orët e edukimit fizik dhe duhet që fusha të rrethohet minimalisht.

Zv. kryetari – a keni pasur kontakte me drejtorinë arsimore në Shkodër? Pjesë e këtyre shërbimeve të mirëmbajtjes duhen zgjidhur dhe do të kenë vemendje maksimale nga ana e jonë.

Uji i pijshëm është ndoshta më vështirë gjithë do ti evidentojmë të gjitha këto problematika.

Vjoleta Hoxha, Drejtoreshe Shkolla “Agim Tafili”- i kemi derguar edhe me shkresë dhe e-mail kërkesat tona, por kemi nevojë:

1. Të bëhet riparimi i dyerve, dorëzave e klasave.
2. Problem madhor kemi ujin dhe ne e kemi zgjidhur vetë në mënyrë vullnetare shtrimin e ujsjellsit por shkolla vijon të jete pa ujë. Shkolla ka edhe detyrat e shtëpisë këtu dhe megjithëse kemi dy depozita ato janë jashtë funksionit dhe nuk arrijmë të kemi ujë të pijshëm për nxënësit.

Ka ardhur edhe ISHP dhe shprehet se duhet mbyllur shkolla duke qënë se sa herë vjen nuk ka ujë. Prandaj kërkojmë që ose të bëhet shpim në oborr ose të hapet uji në 7 dhe jo në ora 2 e gjysëm siç ndodh vertetë. As në tualete as për ujë të pijshëm.

Ka tetë vite që e shtroj këtë problematik kemi shtruar vetë edhe tubat por duhet që ujësjellësi duhet të hap ujin në orarin e duhur kur frekuentohet nga nxënësit

Kullimi në oborr duhet të verifikohet sepse përdorim këtë oborr për edukimin fizik dhe behët shumë ujë, që nuk kullon askund.

Aleksander Pashuku – ky është një problem i mbartur dhe megjithëse kemi 2 depozita nuk funksionojnë dhe duhet të sjellim një hidraulik apo teknik që të verifikojnë këtë pjesë. Do të kontaktojmë drejtorin e arsimit dhe do të sjellim medeomos një teknik për të riparuar dhe verifikuar këtë situatë.

Brisela Kadia – është problem kjo pjesë dhe duke qënë se mësimi shkon deri në ora 4 e 30 duhet të ketë prioritet kjo pjesë për shkollat.

2.Menaxhimi i mbetjeve

Cila është situata ?

Koshat përpara shkollës por edhe koshat e tjerë në njësi të cilët janë të dëmtuar duhen zëvendësuar por situata është mirë në këtë zonë.

3- Shërbimet ne komunitet

Hajri Velija, kryetari fshati Berdicë – nuk janë pastruar asnjë herë, asnjë investim nuk është bërë. Varrezat e fshatit Bërdicë e sipërme, kemi paguar vetë dhe asnjë herë nuk janë pastruar nga komuna.

Aleksander Pashuku – ne kemi ndërhyrë në Trush, ku është fushe dhe ka nevoja më shumë ndërsa për varrezat e tjera kemi pasur bashkëpunimni e GIZ për të bërë pastrimet e tyre ndërsa në Bërdicë të madhe, Mali Hebjaj janë pastruar nga komuniteti.

Zv. kryetari – Do të shtohet vemëndja për këtë pjesë delikate.

4- Ndriçimi rrugor dhe shërbimet rrugore

Aleksander Pashuku - Në lagjet dhe rrugët kryesore është bërë ndriçimi publik. Tek rruga kryesore e Trushit që shkon për lagjen “Maksut” ka nevojë të vendosen dy bume. Trush, Bërdicë e sipërme dhe Bërdicë e mesme, në të gjitha rrugët ku është bërë asfalt, ka pasur vendosje të ndriçuesve. Por është e nevojshme të vendosen ndriçuesat edhe në Beltojë.

Në fshatin Malihebe po ashtu ka nevojë për të pasur ndriçim shtesë dhe të ndërrohen ndriçuesat që janë në gjëndje dhe të prishur disa.

Lagjja Peraj, Vataj, Gjonajt dhe Malsorët e Mullinit ku nuk ka asnjë ndriçues ose të investohen nga bashkia ose të vendosen nga ana e jonë privatisht dhe të lidhen me shërbimin publik të ndriçimit sepse banorët janë taksa -pagues dhe vetëm me forcat e tyre arrijnë ta mbulojnë këtë pjesë.

Rruga Gjorretej është bërë asfalti ka shtylla dhe duhet të vendosen ndriçuesit ka shumë komunitet dhe është e nevojshme që të vendosen këto drita.

Fshati Trush, Aleksander Lukani – banor në zonën e prekur nga termeti – as kemi shtrim rruge dhe as kullim të ujit, kemi nevojë për rehabilitim të rrugës, quhet lagjja e termetit dhe që nga ‘79 nuk është investuar në rehabilitimin e rrugës dhe as kanaleve kulluese po ashtu as tek zona pranë qendrës shëndetsore.

Bilal Dani – Nevojat janë të mëdha por duhet të diskutojmë me kembë në tokë për këtë pjesë sepse duhet që të gjithë të ndergjegjsohemi dhe të japim llogari për problemet që kemi, janë bërë investime por dikush duhet të japë llogari për ato që nuk janë bërë mirë, të bëhen më të shpeshta këto takime sepse duke dhenë llogari me shpesh dy apo tre herë në vit është me e thjeshtë që secili të kuptojë se çfarë është bërë dhe çfare nuk është bere. Ka llampa te djegura të cilat nuk janë riparuar dhe nuk kushton asgjë ndërrimi i tyre e kjo bëhet përmes kërkesës dhe dhënie se llogarisë

Ndrec Kastrati, banor Bërdicë e sipërme – rruga që është shtruar nuk është me ndriçim dhe është shumë e nevojshme kjo gjë .

5- Menaxhimi i ujitjes dhe kanaleve kullues

Koleci, banor Trush.- Sa i përket kanaleve kulluese, së pari tani që fillojnë shirat është shumë problem pranë shkollës ku grumbullohet uji.

Aleksander Pashuku - duhet që të drejtohem me një shkresë për këtë zonë, banorët kanë vendosur tubat dhe i kanë bërë ndërhyrjet por është e pamundur që të riparohet kështu por duhet t'i drejtohem bashkisë me një shkresë.

Urat që realizohen nuk mund të vijojnë dhe të futen tuba 80 cm ndërkohe që kanali është 2 meter. Do të bejmë shkresa që mbetet ne sistem dhe kemi me mundësi per ti gjurmuar dhe kërkuar llogari .

Në lidhje me kullimin, bashkia me Bordin e Kullimit në Lezhë, kanë hapur kanalet e para duke mbuluar shumicën e territorit të Bërdicës .Edhe kanalet e dyta e të treta janë hapur dhe Bërdica nuk ka pasur më këto rreshje problem me kullimin duke e zgjidhur si situatë. Problem kemi Brenda lagjeve ku ne vetë kemi bllokur kanalet

Luani, banor fshati Trush – kemi 30 vite që ngrejmë këto probleme. Ne jetojmë pranë qendrës shëndetsore Trush dhe kemi vite që kerkojme këtë ndërhyrje për sa përket kullimit të lagjes dhe sot ka renë shi dhe lagjja është e pakalueshme Kullimi është i nevojshëm dhe ka vetëm 200 metra rrugë.

Po ashtu tek rruga e Kall dramit, është e nevojshme të ndërhyhet sepse janë 2 km rrugë që të dergojnë tek pjesa e tokave bujqësore. As ka tabela sinjalizimi apo emertim te fshati. Per sa i perket Trushit, aty ka kanal vaditës dhe është kanali kryesor por ka nevojë per pastrim me fadrome.Rruga Tulej, po ashtu krijon problematika në ditë me shi sepse behët e pakalueshme.

Zefi, banor Beltoj – ujërat që bijnë dhe shirat nuk lejojnë që të futemi në rrugë e cila nuk është me e kalueshme, prandaj duhet të ketë ndërhyrje për kanalin dhe kullimin e kësaj rruge.

Në Beltoje nuk është bere asnjë ndërhyrje dhe te paktën të bëhet kjo rrugë 100 metër e gjatë.

Rruga nga Ura e Blinit nuk ka kanal dhe e kemi hapur vetë por duhet ndërhyrje sepse është mbyllur sërish nga një person që ka bërë ndërhyrje privatisht aty. Ne kemi berë ankesa por asgjë nuk ka ndryshuar.

Bilal Dani – që kur është filluar investimi dhe është perfunduar ka shumë banorë që nuk janë likujduar akoma , duhet te angazhohet edhe partia socialiste për këtë problem sepse shkohet e vihet nëpër ministri dhe akoma nuk ka një zgjidhje.

Zef Shani , Trush – jetoj në lagjen Trush dhe është nen kuotën e rrugës së tokës dhe përmbytet është 100 meter rrugë Prandaj duhen berë verifikimet e nevojshme sepse në këtë situatë jemi 12 – 20 familje dhe kalon i gjithë Trushi në kete zonë.

1. Fshatit Bërdicë e sipërme i është premtuar disa here por nuk është bere asnje per rrugen e varrezave.
2. Trotuare tek Harku Berdice deri në Bahçallek qe nuk u bënë kurrë dhe është me shumë rëndësi për të gjithë banoret por edhe nxënësit që shkojne deri në Bahçallek për të marre autobusin.

Zv. kryetari - kësaj rruge i është bere edhe projekti dhe me siguri do te kemi të mundur që ta realizojmë.

Ylli Simoni, kryeplak Bërdicë e madhe – kemi problem me kabllorin, investimin qe është bërë nga OSHEE por rruga nuk është sistemuar. Edhe tek rruga për Malihebej i gjithë asfalti është dëmtuar. Duhet të shikohet nga bashkia kjo situatë.

Eglant Rexha, banor fshati Trush – duhet të rishikohet asfaltimi i qendrës Trush, trotualet kullimet e gjithë qendra me një shi është e mbushur me ujë edhe rruga nga Trushi për në shkollë te pakten njera pjese te jete me trotuar.

Bilal Dani - kemi një kerkese tjetër qe është në emër të komunitetit , investimi i OSHEE me kabullin kacurrel.

Banore, lagjja Muhaj :

1. Rruga pranë qendres shendetshore në Trush nuk ka as kosh mbeturinash, rruga është e shkatërruar dhe nuk ka asnjë nderhyrje .

Qendra shëndetsore në Bërdicë. Nga harku i Berdices deri ne Trush nuk ka asnje stol dhe të paktën një shesh. Qendra shëndetsore është nën nivelin e rrugës dhe normalisht një shi që bjen e përmbyt

1. Qendër shëndetsore është 2 me 1.2 pra është shumë e vogel dhe ka nevojë për të pasur një të re.
2. Rruga Bahri Gjyli dhe rruga e Mehajve janë rrugë të vogla dhe mund të ndërhyhet shumë lehtësisht
3. Po ashtu kisha një kërkesë per Zyren e Bujqesise : nuk e di se si mund të ndihmohen por është 70 % e popullsisë me Amtp dhe sa është e mundur që bashkia ti ndihmoje me hartat topografike.

Alban Sekaj - me ligjin e ri që ka dalë ka ndryshuar formati dhe duhet që banorët të paraqiten në Hipotekë me hartat topografike private. Kemi problem me hipotekën dhe ekspertat e tyre sepse na sjellin pergjigje të pakuptimta sepse janë bërë shumë mbivendosje dhe ka problem dhe konflikte mes banorëve për mbivendosje dhe legalizimet.

Banor i fshatit Berdicë - një pjesë e mirë ka ujë por ujësjellsli e mbyll dhe e mban me orare hapjen e ujit. Janë shpuar tubat e ujit furnizues dhe është a është e mundur që të vijnë dhe të riparohen këto tuba që mos të ketë humbje në rrjet. Tek Harku i Berdicës është dëmtuar tubi dhe krijon shumë problem. Të paktën aty ku ka mundësi të mbyllen dhe të mos futen edhe ujrut e pista në këto tubacione ku ka ujë.

Banor, fshati Trush – Në trush nuk ka ujë dhe asnjë banor nuk ka ujë në shtëpia. Duhet parë me përparësi kjo ceshtje.

Brisela Kadia – Situata është kjo qe është në fakt dhe dëshira për të bërë është e madhe por këto jane mundësitë por ne nuk e shfrytezojmë politikisht këtë pjesë, kemi krijuar lidhje edhe me ju që ju të keni të mundur të shikoni se cfarë prezantohet ne Këshill dhe cfarë realizohet në terren.

Gjatë diskutimeve që bëjmë dalin edhe probleme që kanë varësi direkte nga qeveria ne morëm një angazhim që problemet që kanë lidhje me Oshee, Kadastrën etj, ti adresojmë tek institucionet me anë të Prefektit.

Zv/Kryetari i Bashkisë :

Duke ju falenderuar për opinionet dhe nevojat e paraqitura ju falenderoj sërish dhe shpresojmë që të kemi mundësinë të realizojmë këto propozime të bera sot këtu nga ana juaj.


Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka. Mbledhja deklarohet e mbyllur.

Mbajtësi i Procesverbalit:

Bekim Mema








BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun -Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2023-2025.

Nj.Administrative Bërdicë

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
1	Gezim	Jula	M	57	Tresh	Shpirtëror	P.A.Punë
2	Reham	Çekëlla			Tresh	Hidraulik	P. Punë
3	Zuallmet	Mehja			Tresh	Konçer	P. Punë
4	Gerardina	Mustofa			Tresh		
5	Vhëlbiri	Zuallmet			Tresh		
6	Sander	Samir	M	61	Bardhe e Madhe	Ekonomist	OKSH
7	Shavit	Pallumbi	M	56	Tresh	Agronom	Bashki
8	Ilir	Simona	F	64	B. Naothe		Privat
9	Lasper	Jaçuka	M	62	Bebaze	Agronom	Ushakës
10	Hajri	Veliç	M	53	Berdic Sipër	Kryeprok	Privat
11	Shavit						
12	Giljeta	Shavit	F	33	Shkodër	Ekonomist	B. Shkodër
13	Elme	Pirdinç	F	33	Shkodër	Ekonomiste	B. Shkodër

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK




BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun -Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2023-2025.
Nj.Administrative Bërdicë

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
14	Jasmina	Gercani	F	38	Shkodër	Ekonomik	B. Shkodër
15	Alfred Dula		M	55	Shkodër	Jurist	B. Shkodër
16	Alban	Lejla	M	52	Shkodër	Agron	B. Shkodër
17	KOLË	PATANI	M	40	TRUST	MARANGOZ	PRIVAT
18	Alkison Topshka		M	56	Bardie Mena	Pomer	22004
19	Bild	Doni	M	65	Bardie Mena	Shumë	si Ad.
20	Murat Melyza	Mehre	M	60	Shkodër	Morës	Sh.ub. Bërdicë
21	Besë	Se'ullumbi	F	53	Jurist	Qeritues	"Veit Can Topani"
22	Viola Koxho		F	45	Bërdicë	Shkollës	"Apim Topshka"
23	Jemil	Albi	M	28	Bërdicë e Shkollës	Shkollës	7 B. Shkodër.
24	Ysej Kaloza		M	58	Bërdicë		Shkodër
25	SAZER MARI		M	62	MAKËRË	VEREARNER	PA QUN

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK



BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun -Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2023-2025.

Nj.Administrative Bërdicë

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
26	Enona	Ullat	M	45	Berdicë e Sipërme		B. Shkodër
27	Ilirija	Sani	M	36	Berdicë e Mëposhtme	Financier	Ujt - Ap' - Dopper
28	Flavio	Ullat	M	34	TRUSH	Jurist	M/A - BERDICE BASHKIA SHKODËR
29	Eglanet	Rexha	M	32	Trush	Jurist	S. Popuj

COORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK _____